



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



Raporti
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin shtator 2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim përditësimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, lejomëni të ndaj me ju raportin e muajit shtator 2019 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Në aktivitetin “Tirana Tech Open 2019”, i cili mbledhi së bashku përfaqësues të bizneseve, universiteteve, Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), agjensi të ndryshme dhe të rinj të angazhuar në fushën e inovacionit dhe zhvillimit të teknologjisë u fokusua në iniciativën e hartimit të projektligjit për start-upet inovative dhe mbi reformat që ka ndërmarrë qeveria në drejtim të lehtësimit të digjitalizimit të procedurave në platforma online.

Konferenca me temë “Kërkimi Shkencor në Hapësirën Mbarëshqiptare dhe Roli i Diasporës Shkencore” solli në Shqipëri studiues dhe kërkues të njohur nga diaspora shqiptare për të ndarë arritje shkencore gjatë paneleve të organizuara gjatë kësaj konference. Si një iniciativë për t’u mbështetur, ju dha rëndësi e veçantë bashkëpunimit midis diasporës dhe institucioneve publike në vend për të krijuar një zhvillim më të madh në të ardhmen.

Pjesëmarrja në Forumin ekonomik në Poloni u përqëndrua në eksperiencat dhe praktikat më të mira të bashkëpunimit rajonal. Gjatë zhvillimit të këtij forumi diskutuam në lidhje me strategjinë e BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian (EUSAIR) si një platformë bashkëpunimi efikase.


Në mbledhjen e radhës të Këshillit të Investimeve u theksua rëndësia e jashtëzakoshme e komunikimit me sipërmarrjen në mënyrë që të bëhet e mundur veçanërisht evidentimi i

sektorëve prioritarë të cilët mund të ndikojnë në zhvillimin ekonomik në vendin tonë. Diagnostifikimi dhe prioritizimi i këtyrë sektorëve do të mundësojë hartimin e politikave ekonomike afatgjata dhe të qëndrueshme si dhe stimulimin e investimeve, me ndikim pozitiv në ekonominë shqiptare. Diskutimet u fokusuan edhe në rritjen e investimeve në Shqipëri gjatë gjashtë mujorit të parë të 2019, si dhe përpjekjeve të shumta për të rritur interesin e bizneseve të huaja për të ardhur në Shqipëri.

Duke shpresuar në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.

Me konsideratën më të lartë,

Eduard Shalsi



Regjistri i ankesave të trajtuara

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 1	MM	11.07.2018	Subjekti kërkon kryerjen e pagesës për sherbimet e kryera në fushën e Emergjencave Civile.	Në proces
Nr. 2	MFE	17.08.2019	Subjekti ankohet për bllokim të padrejtë të kripes nga ana e AKU në pikën kufitare Kakavijë.	Në proces
Nr. 3	Bashkia - Qarku Shkoder	12.01.2019	Subjekti kërkon adresim ose sugjerim të procedurave që duhet të ndiqen përpara të përket transportit urban dhe marrdhënieve me Bashkinë.	Në proces
Nr. 4	MBZHR	17.02.2019	Kërkesë për interpelancë.	Në proces
Nr. 5	Bashkia - Qarku Korçe	25.02.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mosshlyerjen e detyrimeve për projektet e financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale.	Në proces
Nr. 6	Bashkia - Qarku Tiranë	24.02.2019	Subjekti kërkon anulim dhe rishikim vendimi nga ana e Bashkisë.	Në proces
Nr. 7	MIE	14.03.2019	Subjekti kërkon përmirësim të rrugës për të aksesuar biznesin.	Në proces
Nr. 8	Bashkia- Qarku Gjirokaster	25.03.2019	Subjekti ankohet në lidhje me shkeljen e procedurave ligjore në ndërtimin e linjave të rrjetit të shpërndarjes.	Në proces
Nr. 9	MFE	28.03.2019	Subjekti denoncon konkurrencën e pandershme që zhvillohet nga bizneset online të pajisura në QKB që operojnë përmes Instagram & Facebook.	Në proces
Nr. 10	MFE	15.04.2019	Subjekti kërkon të zhvillojë një takim me Zv/kryeministrin.	Në proces
Nr. 11	MTM	15.04.2019	Subjekti kërkon miratimin e procedurës dhe përditesimet përkatëse në kadastrën e pyjeve.	Në proces
Nr. 12	Bashkia - Qarku Vlore	15.04.2019	Subjekti kërkon mbështetje për ngritjen e qendrës së zhytjes në Vlorë.	Në proces
Nr. 13	Bashkia - Qarku Diber	18.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mos likuidimin e faturave dhe dëmin ekonomik të shkaktuar nga Bashkia Klos për objekte tenderimi të perfunduara.	Në proces
Nr. 14	Bashkia - Qarku Vlore	30.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me moslargimin e një barake të shkatërruar nga bashkia.	Trajtuar me përgjigje

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 15	MIE	01.05.2019	Subjekti kërkon pajisjen me leje të përdorimit të ujit për HEC-e ekzistuese e të ndërtuara nga shteti shqiptar por që i janë dhënë shoqërise koncesionare.	Në proces
Nr. 16	MB	17.05.2019	Subjekti kërkon lëshimin e licencave të eksportit dhe interpretimin juridik të urdhrit 661.	Në proces
Nr. 17	Bashkia - Qarku Kavajë	22.05.2019	Subjekti kërkon marrjen e certifikates se përdorimit e cila i është mohuar.	Në proces
Nr. 18	MZHBR	22.05.2019	Subjekti kërkon përgjigje nga AKU në lidhje me gjokat dhe bllokimin e mallit nga ana e AKU.	Në proces
Nr. 19	MD	27.05.2019	Subjekti kërkon asistencë për rihapjen e aktivitetit.	Në proces
Nr. 20	MBZHR	30.05.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mosmarrjen e një leje ndërtimi në fushën e agrobiznesit.	Në proces
Nr. 21	MFE	10.06.2019	Subjekti kërkon takim me DPD në lidhje me një gjoke të vendosur në mënyrë të padrejte.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 22	MIE	10.06.2019	Subjekti pretendon se nuk janë konsultuar në momentin e hartimit të projektit.	Në proces
Nr. 23	Qarku Durrës	10.06.2019	Subjekti kërkon informacion në lidhje me planin zhvillimor të zonës.	Në proces
Nr. 24	MBZHR	10.06.2019	Subjekti ankohet në lidhje me gjokitje të padrejte në fushën e peshkimit.	Në proces
Nr. 25	MIE	09.06.2019	Subjekti ankohet në lidhje me procedurat e prokurimeve.	Në proces
Nr. 26	MFE	11.06.2019	Subjekti CEMA shpk kërkon të punësojë disa nga azilantët iranianë të vendosur pranë fabrikës së tyre, dhe kërkon të dijë nëse kjo është e mundur.	Në proces
Nr. 27	Bashkia - Qarku Durrës	12.06.2019	Subjekti ankohet në lidhje me një ndërtim të parregullt që ndikon në biznesin e tyre.	Në proces
Nr. 28	MFE	12.06.2019	Subjekti kërkon ri-shqyrtim të vendimit të zyres doganore.	Në proces
Nr. 29	MBZHR	18.06.2019	Subjekti kërkon të shfrytëzojë ujërat e rezervuarit të Belesovës për prodhimin e energjisë elektrike.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 30	MBZHR	18.06.2019	Subjekti kërkon anulim dhe ndryshim të disa masave administrative "dënim me gjobë".	Në proces
Nr. 31	MBZHR	19.06.2019	Subjekti pretendon se konkurrentet nuk plotesojne kushtet per prokurimin publik "Blerje automjetesh".	Trajtuar me përgjigje
Nr. 32	MIE	19.06.2019	Subjekti ankohet lidhur me procedurat e prokurimit.	Në proces
Nr. 33	MIE	18.06.2019	Subjekti kërkon informacion mbi statusin e çështjes gjyqësore në Apel mes SBM Group dhe MEI dhe Mati Hydropower si palë e tretë.	Në proces
Nr. 34	MFE	20.06.2019	Subjekti kërkon shtyrjen e afatit të Magazinës së Lirë ML-13, miratimin e shtimit të kapacitetit/sipërfaqes mbajtës të depozitave të karburantit në autorizimin e për magazinë të lirë.	Në proces
Nr. 35	MD	21.06.2019	Subjekti kërkon leje për përdorimin e plazhit perpara pronës së tij.	Në proces
Nr. 36	MD	24.06.2019	Subjekti kërkon asistencë për aplikimin në hipotekë.	Në proces
Nr. 37	MSHMS	25.06.2019	Subjekti denoncon autobotet që tregtojnë ujë të pijshëm jashtë kushteve higjieno-sanitare.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 38	MIE	26.06.2019	Subjekti kërkon që MIE të marrë një vendim për zbardhjen e lejes së ndërtimit në lidhje me ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaik.	Në proces
Nr. 39	MFE	26.06.2019	Subjekti ankohet në lidhje me përdorimin e cmimeve të pasakta nga ana e doganës për zhgodanimin e produkteve.	Në proces
Nr. 40	APP	26.06.2019	Subjekti ankohet mbi procedurat e prokurimeve me shkelje nga AK.	Në proces
Nr. 41	MIE	02.07.2019	Subjekti ankohet në lidhje me përfundimin e një kontrate qiraje në mënyrë të padrejtë.	Në proces
Nr. 42	MIE	02.07.2019	Subjekti kërkon liste të drejtuesve teknik të cilët kanë license si mbikqyres dhe kolaudues punimesh.	Në proces
Nr. 43	MIE	04.07.2019	Subjekti kërkon anulim dhe rishikim vendimi nga ana e Bashkisë.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 44	MD	10.07.2019	Subjekti ankohet per zvarritje te dhenies se nje certifikate pronesia nga ana e ZRPP, pasi ky i fundit kerkon nje dokument i cili eshte dorezuar me pare nga subjekti.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 45	MTM	10.07.2019	Subjekti ankohet ne lidhje me sjelljen dhe punën e Drejtorise Rajonale te Mjedisit ne Durres	Në proces
Nr. 46	MFE	10.07.2019	Subjekti kerkon rishikimin e VKM nr. 437 date 26/06/2019.	Në proces
Nr. 47	MFE	17.07.2019	Subjekti denoncon disa subjekte te cilat sipas tij merren me kontrabande.	Në proces
Nr. 48	Bashkia - Qarku Tiranë	19.07.2019	Subjekti ankohet për mos kthim përgjigje nga ana e Bashkisë Tiranë.	Në proces
Nr. 49	Inspektoriati shteteror teknik dhe industrial	19.07.2019	Subjekti kerkon heqjen e gjobave dhe barres hipotekore ne lidhje me karburant te kualifikuar si me cilesi te dobet.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 50	MIE	22.07.2019	Subjekti kerkon anulimin e VKM NR.835, date 15.2.2009.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 51	Bashkia- Qarku Vlorë	24.07.2019	Subjekti ankohet per disa ndertesa perpara hotelit, te cilit eshte duke ndertuar, qe i prishin imazhin e zones.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 52	Bashkia - Qarku Tiranë	24.07.2019	Subjekti kerkon te hiqen nga sistemi gjobat te cilat i ka paguar nepermjet bankes.	Në proces
Nr. 53	MiSHMS	30.07.2019	Subjekti kërkon të zhvillojë një takim me Ministrin e Financave.	Në proces
Nr. 54	MFE	01.08.2019	Subjekti pretendon se i eshte komunikuar padrejtesisht se ka kaluar afatet per dorezim dokumentash pas shpalljes fitues nga ana e nje autoriteti kontraktor.	Në proces
Nr. 55	MDE	31.07.2019	Subjekti pretendon se ka marre mase administrative (gjobe) pa qene ne dijeni te ndonje shkeljeje ligjore.	Në proces
Nr. 56	MFE	01.08.2019	Subjekti ankohet ne lidhje me parregullsi ne pagesat e tatimeve.	Në proces
Nr. 57	KM	01.08.2019	Subjekti kerkon vendosjen si ceshtje ne rendin e dites ne mbledhjen e ardhshme te AZHT-se rastin e hidrocentraleve Kalivare.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 58	Bashkia - Qarku Tirane	05.08.2019	Subjekti ankohet per skualifikim, sipas tij te padrejte, nga nje tender.	Në proces
Nr. 59	MB/Bashkia - Qarku Sarande	06.08.2019	Subjekti ankohet per konkurrencen qe i bejne taksite e palicensuara.	Në proces
Nr. 60	MIE	06.08.2019	Subjekti ankohet ne raport me treguesin e sqfurit ne solar qe do te ndryshohet pas dates 31.12.2019 nga 1% ne 0.1%.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 61	Ministria e Kulturës	06.08.2019	Kerkese per mbeshtetje te projektit per kthimin e burgut te Spacit ne ambient bashkekohor dhe funksional te kujteses.	Në proces
Nr. 62	MFE	06.08.2019	Subjekti ankohet për KLSH, pasi sipas tij KLSH nuk ka të drejtë të rekomandojë për penalitet subjektet private.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 63	MFE	08.08.2019	Subjekti ankohet se ka porositur një produkt dhe i ka ardhur pa faturë.	Në proces
Nr. 64	MFE	13.08.2019	Subjekti kërkon të vendoset rregulli me drejtuesit e institucioneve që kanë lidhje t drejtpërdrejtë me ushtrimin e aktivitetit të tij.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 65	MBZHR	14.08.2019	Subjekti kërkon financim nga shteti për tëmbuluar shpenzimet si pasojë e një fatkeqësie natyrore.	Në proces
Nr. 66	MFE	17.08.2019	Subjekti ankohet për mos lëshimin padrejtësisht të certifikates se blerjes se mallit nga ana e Shega Trans	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 67	MFE	20.08.2019	Subjekti ankohet për probleme në marrjen e licencës.	Në proces
Nr. 68	Bashkia - Qarku Korçë	21.08.2019	Subjekti kërkon të hiqet taksa e ndikimit në infrastrukturë siç është e parashikuar në ligj.	Në proces
Nr. 69	MIE	21.08.2019	Subjekti kërkon ndryshim te VKM nr. 429, Date 26.06.2019, pasi nje produkt me kriteret e kerkuara nuk ekziston.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 70	MIE	21.08.2019	Subjekti kerkon mbeshtetje institucionale per ralizimin e hidrocentralit Kasaj në Mirditë	Në proces
Nr. 71	MFE	21.08.2019	Subjekti denoncon ndryshimin e veprës penale "Shperdorimi i detyrës në Bashkëpunim" sipas nenit 248 dhe 25 të Kodit Penal	Trajtuar me përgjigje
Nr. 72	MBZHR	22.08.2019	Subjekti ankohet për një gjobaë nga ana e AKU Fier.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 73	Bashkia - Qarku Tirane	27.08.2019	Subjekti ankohet për mos shlyerje të një vlere të konsiderueshme për ndërtimin e një ujësjellësi në vitin 2006.	Në proces
Nr. 74	MD	28.08.2019	Subjekti kërkon informacion mbi dy akte nen-ligjore.	Në proces
Nr. 75	Bashkia - Qarku Durres	28.08.2019	Subjekti kërkon të merren masa për verifikimin e lejes së ndërtimit të një kolektori, në mënyrë që të vijohet më tej me vazhdimin e investimit.	Në proces
Nr. 76	MBZHR	21.08.2019	Subjekti kërkon që të merren masa të menjehershme nga MBZHR që të bëhet i mundur dorëzimi fizik i parcelave dhe regjistrimi i tyre në hipoteke, konform udhërimeve të Kontratës së Qerasë.	Në proces
Nr. 77	Bashkia - Qarku Krujë	28.08.2019	Subjekti kërkon t'i vihen në dispozicion Tarifat dhe Taksat Vendore për vitet 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019	Në proces
Nr. 78	MIE	28.08.2019	Subjekti kërkon takim me Kryeministrin për të diskutuar rreth mundësive për permiresim të logistikës në portin e Durresit.	Në proces
Nr. 79	MFE	29.08.2019	Subjekti ankohet për mbifaturim të cmimit të energjisë elektrike.	Në proces
Nr. 80	MBZHR	29.08.2019	Subjekti ankohet për bllokim të padrejtë të kripes nga ana e AKU në pikën kufitare Kakavije.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 81	MIE	29.08.2019	Subjekti ankohet për mbifaturim të cmimit të energjisë elektrike.	Në proces
Nr. 82	MIE	29.08.2019	Subjekti ankohet për mbifaturim të cmimit të energjisë elektrike.	Në proces
Nr. 83	MIE	29.08.2019	Subjekti ankohet për mbifaturim të cmimit të energjisë elektrike.	Në proces
Nr. 84	MIE	29.08.2019	Subjekti ankohet për mbifaturim të cmimit të energjisë elektrike.	Në proces
Nr. 85	Bashkia - Qarku Vlorë	30.08.2019	Subjekti ankohet pasi pretendon se disa persona të panjohur i kanë zaptuar një pjesë të tokës ku zhvillon aktivitetin.	Në proces
Nr. 86	MSHMS	02.09.2019	Subjekti kërkon verifikimin e produkteve larvicide në programin e dizinfektimit të bregdetit për vitin 2018.	Në proces
Nr. 87	MFE	03.09.2019	Subjekti kërkon ndihmë nderinstitucionale për likuidimin e detyrimit nga Drejtoria e Tatimeve	Në proces
Nr. 88	MFE	04.09.2019	Subjekti ankohet për akuzat e pavërteta që i bëhen nga kundërshtarët në lidhje me cilësinë e produkteve që tregton.	Trajtuar me përgjigje

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 89	Bashkia - Qarku Rrogozhinë	04.09.2019	Subjekti kërkon të rritet fuqia e tensionit të energjisë elektrike në një zonë turistike, ku ushtron dhe aktivitetin e tij.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 90	MFE	19.09.2019	Subjekti kërkon kompensim.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 91	Bashkia -Qarku Tepelenë	09.09.2019	Subjekti kërkon të marrë me qera, kundrejt detyrimeve tatimore një pjesë toke pranë qendrës së qytetit.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 92	MFE	10.09.2019	Subjekti kërkon formalizimin e biznesit të autoshkollave.	Në proces
Nr. 93	APP	10.09.2019	Subjekti pretendon se fituesit e një tenderi janë të paracaktuar dhe se ka konkurrencë të padrejtë.	Në proces
Nr. 94	MFE	10.09.2019	Subjekti kërkon ndihmë për të negociuar për ristrukturim kredia pranë një banke te nivelit të dyte.	Në proces
Nr. 95	MFE	12.09.2019	Subjekti ankohet për një taksë të re që i faturohet në lidhje me heqjen e mbeturinave.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 96	Bashkia - Qarku Vlorë	24.07.2019	Subjekti kërkon t'i mundësohet sa më shpejt leja për ndërtimin e strukturës akomoduese, si dhe të prishen barakat që janë buzë detit duke i prishur imazhin strukturës.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 97	MFE	11.09.2019	Subjekti denoncon konkurrentin për aktivitet të padëklaruar.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 98	MFE	12.09.2019	Subjekti ankohet për një taksë të re të vendosur nga qeveria për mbeturinat.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 99	Bashkia - Qarku Diber	12.09.2019	Subjekti ankohet se Bashkia Dibër nuk i ka likuiduar një faturë për blerjen e një sasive druri zjarri.	Në proces
Nr. 100	MIE	13.09.2019	Subjekti ankohet për mbifaturimin e energjisë elektrike.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 101	MFE	13.09.2019	Subjekti ankohet për probleme me rimbursimin e akcizës dhe TVSH-së.	Në proces
Nr. 102	MTM	13.09.2019	Subjekti ka hasur ne veshitresi pas riformatimit te kabinetit qeveritar me 2017, me identifikimin e autoritetit kontraktor.	Në proces
Nr. 103	MFE	13.09.2019	Subjekti ka ankimuar vendimet Nr.121 - 128 datë 19.07.2019, nr.154 - 178 datë 19.07.2019 dhe datë 23.07.2019 të Degës së Doganës Vlorë	Trajtuar me zgjidhje

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 104	MFE	13.09.2019	Subjekti kërkon të fshijë memorien fiskale të kasës por nuk po gjen zgjidhje nga institucionet ku është ankuar.	Në proces
Nr. 105	MD	14.09.2019	Subjekti ankohet pasi nje punonjës i institucionit pranë tij, dëmton qëllimisht linjat e internetit.	Në proces
Nr. 106	MD	16.09.2019	Subjekti pretendon se VKM nr 914 dt 29.12.2014 neni 27 pika 8 është mjaft diskriminuese për shoqëritë pjesëmarrëse në tenderat e ushqimeve që behen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.	Në proces
Nr. 107	MD	16.09.2019	Subjekti ankohet për probleme me shoqërinë përmbartimore.	Në proces
Nr. 108	MFE	16.09.2019	Subjekti kërkon të bëhet pjesë e konsultimeve publike me biznesin.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 109	Bashkia - Qarku Shijak	17.09.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mosmarrjen e një leje ndertimi në fushën e agrobiznesit.	Në proces
Nr. 110	MTM	17.09.2019	Subjekti ka ideuar një aplikacion të cilin e konsideron të suksesshëm dhe propozon që përdorimi i tij të shtrihet dhe më gjerë në territorin shqiptar.	Në proces
Nr. 111	MFE	18.09.2019	Subjekti ankohet për bllokimin e llogarive bankare nga ana e administratës tatimore.	Në proces
Nr. 112	MBZHR	11.09.2019	Subjekti kërkon zhblokimin e një ngarkese me produkte ushqimore i cili është bllokuar nga AKU.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 113	MFE	18.09.2019	Subjekti ankohet për probleme në lidhje me rimbursimin e TVSH-së.	Në proces
Nr. 114	MFE	19.09.2019	Subjekti kërkon të regjistrohet në QKB.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 115	MFE	19.09.2019	Subjekti kërkon të shlyej taksat e prapambetura me TVSH-në që do i kompensohet.	Në proces
Nr. 116	MASR	19.09.2019	Subjekti kërkon të ndryshojë drejtuesin didaktik.	Në proces
Nr. 117	MIE	20.09.2019	Subjekti kërkon zgjidhjen e një kontrate si dhe shlyerjen e nënkontraktorit në lidhje me punimet e kryera.	Në proces
Nr. 118	Bashkia - Qarku Himarë	20.09.2019	Subjekti kërkon të pajiset me hipotekë, sipas lejes së legalizimit që i ka dalë në vitin 2017.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 119	MFE	20.09.2019	Subjekti ankohet për kontrolle të shpeshta tendencioze nga ana e administratës tatimore, si dhe për dëmtim imazhi pas publikimit të një lajmi të pabazuar në fakte.	Në proces
Nr. 120	KM	23.09.2019	Subjekti kërkon anulimin e Vendimit nr. 269, dt. 02.05.2019.	Në proces
Nr. 121	KM	23.09.2019	Subjekti kërkon të rimarrë një objekt me qera ku të ushtrojë aktivitetin.	Në proces
Nr. 122	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore	24.09.2019	Subjekti pretendon se paguan taksa për pastrimin, gjelberimin e të tjera për furgonin e kompanisë.	Në proces
Nr. 123	MTM	25.09.2019	Subjekti kërkon marrjen në përdorim të fondit pyjor për sipërfaqet e prekura nga nën objektet e Hec-it.	Në proces
Nr. 124	Bashkia - Qarku Lushnjë	25.09.2019	Subjekti pretendon se është skualifikuar në mënyrë të padrejtë nga konkursi prokurimit ku kishte dalë fitues.	Në proces
Nr. 125	KM	24.09.2019	Subjekti kërkon mundësimin e një ndërtimi për një investim.	Në proces
Nr. 126	Bashkia - Qarku Malësi e Madhe	26.09.2019	Subjekti ankohet për vonesa të lëshimit në marrjen e faturës së infrastrukturës.	Në proces
Nr. 127	Kryeministria	08.05.2019	Subjekti kërkon lejin e ushtrimit të aktivitetit të ndërtimit të jahteve në zonat e konsideruara "brigje".	Në proces
Nr. 128	MFE	21.05.2019	Subjekti ankohet në lidhje me situatën pothuajse monopol në treg në lidhje me shoqëritë inspektuese të ashensoreve.	Në proces
Nr. 129	AMF	14.05.2019	Subjekti ankohet në lidhje me falimentimin e shoqërisë dhe problematikat e shkaktuara të grupit respektiv.	Në proces
Nr. 130	MFE	01/09/2019	Subjekti kërkon pezullimin e përkohshëm të rentës minerare, subvencionimin e energjisë elektrike si dhe rimbursimin në kohë të TVSH-së.	Në proces
Nr. 131	MIE	01/09/2019	Subjekti ankohet për moskthim përgjigjeje në lidhje me pajisjen me leje për përdorimin e rezervave ujore.	Në proces
Nr. 132	MTM	02/09/2019	Subjekti ankohet për mungesë bashkëpunimi në lidhje me implementimin e një projekti resort në zonën e Divjakës.	Në proces
Nr. 133	MIE	10/09/2019	Subjekti ankohet për mungesën e dokumentacionit të cilin pretendohet të jetë dorëzuar në AKBN.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 134	MK	09/09/2019	Subjekti ankohet në lidhje me moszbatimin e legjislacionit mbi të drejtat e autorit.	Në proces
Nr. 135	Bashkia - Qarku Klos	11/09/2019	Subjekti ankohet në lidhje me mungesën e likuidimit nga ana e Autoritetit Kontraktor për një projekt asfaltimi rruge.	Në proces
Nr. 136	Bashkia - Qarku Tiranë	17/09/2019	Subjekti denoncon sjelljen abuzive të disa punonjësve të IKMT	Në proces
Nr. 137	MIE	19/09/2019	Subjekti ankohet në lidhje me një ndërtim I cili nuk zbaton kërkesat e Kodit Rrugor.	Në proces
Nr. 138	MTM	24/09/2019	Subjekti kërkon ndalimin e të gjithë hidrocentraleve në ujëmbledhësin e Vjosës.	Në proces
Nr. 139	MFE	25/09/2019	Subjekti ankohet për tregtimin kontrabandë të një produkti për të cilin ka të drejta ekskluzive.	Në proces
Nr. 140	Bashkia - Qarku Tiranë	30/09/2019	Subjekti ankohet për sjellje jo të saktë dhe mungesë dokumentacioni nga ana e IMT.	Në proces
Nr. 141	MFE	30/09/2019	Subjekti ankohet për bllokimin e padrejtë të kryer ndaj tyre.	Në proces
Nr. 142	MIE	30/09/2019	Subjekti ankohet për veprimtari të paligjshme të një shoqërie që ka mbivendosur adresën në QKB mbi shoqërinë ankimuese.	Në proces
Nr. 143	MFE	02/08/2019	Subjekti ankohet në lidhje me gjobat e vendosura nga DPT	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 144	MIE/MTM	28/08/2019	Subjekti kërkon lehtësime për veprimtarinë e operimit turistik në Portin e Sarandës	Trajtuar me përgjigje
Nr. 145	MPB/MFE/MD	11/07/2019	Subjekti ankohet për kopjim marke tregtare dhe marrjen e masave ndaj subjektit që ka kryer fallsifikimin.	Trajtuar me zgjidhje